

# BULETIN INFORMATIV

Aktivitetet e muajit Shkurt 2026

[www.cp-project.al](http://www.cp-project.al) [info@cp-project.al](mailto:info@cp-project.al)



## Seminar mbi “Përmirësimin e Sistemit të Statistikave të Rendit Publik”

Gjatë muajit shkurt 2026, Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA (EMP), në bashkëpunim me përfaqësues të Policisë së Shtetit, organizoi sesionin e dyte dhe te tretë të serisë së seminareve me titull “Përmirësimi i Sistemit të Statistikave të Prodhuara dhe të Përdorura nga Strukturat e Rendit Publik”.

Seminari mbledhi së bashku përfaqësues të strukturave të rendit publik si nga DPPSH ashtu edhe nga Drejtoritë Vendore të Policisë, duke përfshirë përfaqësues nga Drejtoria e TIK-ut.

Anëtarët e Grupit të Punës vazhduan të punojnë ngushtë me qëllim krijimin e një sistemi funksional të statistikave të rendit dhe sigurisë publike.

Gjatë këtyre seancave, pjesëmarrësit u përqendruan në të dhënat e dobishme për policinë duke shqyrtuar formularët përkatës të statistikave dhe duke ndarë përvoja dhe informacione mbi përmirësimin e përmbajtjes së formularëve të statistikave të rendit publik.

Gjatë sesionit, sistemi aktual i raportimit të statistikave u shqyrtua dhe u krahasua me modelet e

zgjedhura të BE-së.

Përmes këtyre seminareve dhe rezultateve të tyre, Grupi i Punës i përbashkët synon të rrisë saktësinë, besueshmërinë, krahasueshmërinë dhe përdorimin efektiv të statistikave të rendit dhe sigurisë publike, duke mbështetur kështu vendimmarrjen strategjike dhe taktike, duke forcuar transparencën institucionale dhe duke përmirësuar monitorimin e performancës së policisë vendore.

Grupi i Punës do të vazhdojë bashkëpunimin me qëllim rritjen e saktësisë, besueshmërisë, krahasueshmërisë dhe përdorimit efektiv të statistikave të rendit dhe sigurisë publike.

Qëllimi përfundimtar është konsolidimi i standardeve metodologjike dhe përmirësimi i sistemeve të të dhënave të përdorura nga Policia e Shtetit.



## AKTIVITETET KRYESORE:

- ◆ Seminar mbi “Përmirësimin e Sistemit të Statistikave të Rendit Publik”
- ◆ Aktivitete në kuadër të mbështetjes nga Skema e Granteve
- ◆ Përfundon përzgjedhja e projekteve fituese të aplikimeve për thirrjen e dytë të Skemës së Granteve
- ◆ Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe Stafit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë
- ◆ NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjësuere në shkolla



Përfundon përzgjedhja e projekteve fituese të aplikimeve për thirrjen e dytë të Skemës së Granteve

**Thirrja e dytë** për këtë fazë të Skemës së Granteve u shpall në **dhjetor 2025**, duke përfshirë katër rajone: **Tiranën, Gjirokastrën, Kukësin dhe Korçën.**

Në kuadër të një fushate të posaçme ndërgjegjësimit, (OJF) dhe organizatat e bazuara në komunitet u informuan në mënyrë të detajuar mbi skemën dhe mundësitë e financimit të ofruara. Ky

proces informimi rezultoi në dorëzimin e 25 aplikimeve deri në përfundim të afatit të aplikimit.

Gjatë periudhës **janar–shkurt 2026**, në secilin Qark u ngritën **Komitetet Vendore të Përzgjedhjes**. Këto struktura kryen një vlerësim teknik të plotë të të gjitha propozimeve, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara të

vlerësimit. **Rezultatet** e përzgjedhjes janë të kënaqshme: **nga 25 aplikimet e paraqitura, 12 projekte janë miratuar për financim.**

Këto iniciativa pritet të japin një kontribut të rëndësishëm në forcimin e komuniteteve lokale dhe në nxitjen e zhvillimit rajonal.

**Aktivitete në kuadër të mbështetjes nga Skema e Granteve**



Gjatë muajit **Shkurt 2026** u zhvilluan disa aktivitete të rëndësishme në kuadër të forcimit të sigurisë publike, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirjes së komunitetit, veçanërisht të të rinjve.

Në **Malësi të Madhe**, Shkodër u zhvillua takimi i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), i cili shënoi takimin e parë për vitin 2026. Ky takim u zhvillua në kuadër të zbatimit të Skemës së Granteve dhe në bashkëpunim me organizatën **“Gruaja tek Gruaja”** dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet në nivel vendor të bashkisë, policisë dhe arsimit. Takimi u fokusua në prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të Sistemit të Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK), bazuar në të dhënat e mbledhura nga anketimi i qytetarëve në dy nën-zonat e bashkisë.

Përfaqësuesit e Programit SCPA theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor, si një

element kyç për adresimin efektiv të çështjeve të sigurisë publike. U nënvizua gjithashtu se studimi nuk duhet parë vetëm si një raport statistikor, por si një mjet praktik të dhënash, përmes të cilit institucionet vendore mund të reflektojnë mbi çështjet që qytetarët i perceptojnë si pozitive, si dhe mbi fushat ku kërkohet më shumë vëmendje dhe mbështetje institucionale.

Takimi kontribuoi në forcimin e dialogut ndërinstitucional dhe hodhi bazat për identifikimin e prioritetëve dhe ndërhyrjeve konkrete në funksion të rritjes së sigurisë dhe besimit të komunitetit.

Në Lushnje, më **27 shkurt** u zhvillua takimi i parë i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) për vitin 2026 në Bashkinë Lushnje. Me praninë e Kryetares së Bashkisë, **znj. Eriselda Sefa**, dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve lokalë, u diskutuan çështjet të rëndësishme që lidhen me sigurinë

publike në bashki. Gjatë takimit u miratua rregullorja e funksionimit të KVSP dhe nisi puna për hartimin e Planit Vendor të Veprimit, bazuar në të dhëna konkrete dhe nevoja reale të komunitetit.

U prezantuan gjetjet e studimit mbi sigurinë publike në qarkun Fier, me fokus të veçantë në tre zonat policore të Bashkisë Lushnje. U trajtuan çështjet si: Siguria publike dhe parandalimi i zjarreve; Siguria në shkolla; Përmirësimi i ndriçimit në zonat problematike; Parandalimi i kriminalitetit tek të rinjtë përmes aktiviteteve edukative, sportive dhe jashtëshkollore; Fuqizimi dhe përfshirja e grupeve në situatë vulnerabiliteti; Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit **“Skuadra e Sigurisë Publike 2 – Partner për një Komunitet të Sigurt”**, shtetur nga Programi SCPA

## Trajnimi i Patrullës së Përgjithshme dhe Stafit të SKK për Zbatimin e Policimit në Komunitet – Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë



Në datat **17–19 shkurt** dhe **24–26 shkurt 2026**, grupi i shtatë dhe grupi i tetë i **Oficerëve të Patrullës së Përgjithshme** dhe personelit të **Sallës së Komandës dhe Kontrollit të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë** morën pjesë në një trajnim të organizuar nga **Ekipi i Menaxhimit të Programit SCPA**, i zhvilluar në ambientet e **Komisariatit të Policisë Nr. 1**.

Trajnimi u konceptua si një program i kombinuar teorik dhe praktik, me qëllim forcimin e njohurive dhe aftësive profesionale të pjesëmarrësve në lidhje me **filozofinë e Policimit në Komunitet** dhe mënyrat konkrete të zbatimit të saj në aktivitetin e përditshëm të oficerëve të Policisë së Shtetit. Gjatë sesioneve të trajnimit, pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime ndërvepruese, punë në grupe dhe analiza të rasteve praktike, duke shkëmbyer përvoja dhe duke reflektuar mbi sfidat që hasin në terren. Një komponent i rëndësishëm i

trajnimit ishte zhvillimi i **ushtrimeve praktike dhe simulimeve të situatave reale**, ku oficerët punuan në grup për të analizuar dhe zgjidhur skenarë të ndryshëm operativë. Këto ushtrime synonin të nxisnin qasjen **proaktive dhe bashkëpunuese**, e cila është thelbësore për zbatimin efektiv të elementeve të Policimit në Komunitet dhe për ndërtimin e marrëdhënieve të besimit me qytetarët.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe **trajnitit të rasteve të Dhunës në Familje**, duke analizuar procedurat, rolin e policisë në mbrojtjen e viktimave dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse. Ky modul përfshiu si prezantime teorike ashtu edhe ushtrime praktike, të cilat ndihmuan pjesëmarrësit të përmirësonin qasjen profesionale në menaxhimin e këtyre rasteve të ndjeshme.

Në kuadër të ofrimit të një programi trajnimi gjithëpërfshirës dhe ndërinstitutional, **Ekipi i Programit**

**SCPA** bashkëpunoi gjithashtu me **Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**, ekspertët e së cilës zhvilluan sesione ndërvepruese mbi **parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm**, duke theksuar rolin e rëndësishëm të policisë në identifikimin dhe adresimin e hershëm të faktorëve të rrezikut në komunitet.

Gjatë trajnimit u prezantuan dhe u diskutuan edhe **praktikat më të mira të Bashkimit Evropian** në fushën e Policimit në Komunitet, duke krijuar mundësi për shkëmbim përvojash dhe për adaptimin e këtyre praktikave në kontekstin e Policisë së Shtetit.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit përfituan njohuri dhe aftësi të reja që kontribuojnë në **rritjen e kapaciteteve profesionale të oficerëve të Policisë së Shtetit**, duke forcuar zbatimin praktik të filozofisë së Policimit në Komunitet dhe duke mbështetur një qasje më efektive, dhe të orientuar drejt qytetarit

**NSPK-të për edukimin vazhdojnë punën ndërgjegjëse në shkolla**



Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe në përputhje me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1076, datë 14.09.2022, “Për zbatimin e Programit ‘Siguria e të Rinjve’ në shkollat 9-vjeçare publike dhe jo publike,” Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet për Edukimin dhe Punën me të Rinjtë kanë vijuar me përkushtim aktivitetet e tyre gjatë muajit **Shkurt, 2026.**

Objekti kryesor i këtij programi është ngritja e ndërgjegjësimit të të rinjve kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës.

Në kuadër të këtij programi, NSPK-të kanë bashkëpunuar ngushtësisht me koordinatoret vendorë të Zyrave Arsimore Vendore (ZAV), duke hartuar së bashku një kalendar të detajuar mujor për zhvillimin e temave në shkollat 9-vjeçare që ndodhen brenda zonave të tyre policore. Gjatë muajit shkurt, fokusi i veçantë ka qenë te

temat e ndërgjegjësimit kundër bullizmit dhe përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës të cilat përbëjnë prioritetet në edukimin e fëmijëve për mbrojtjen e jetës dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme në përditshmërinë e tyre.

Gjithashtu, janë trajtuar edhe tema të tjera që lidhen me edukimin qytetar, në bazë të kërkesave të komunitetit arsimor dhe situatave specifike të secilës zonë.

Përmes platformës online të monitorimit të aktiviteteve, është vërejtur një angazhim i shtuar nga ana e NSPK-ve që operojnë në komisaritet e qyteteve **Tiranë, Durrës Fier, Lushnje Korçë, Pogradec, Shkodër, Lezhë, Berat, Kukës, Elbasan, Vlorë, dhe Sarandë,**

Këto njësi kanë treguar një intensitet të lartë pune, duke realizuar takime të shumta dhe duke shpërndarë materiale ndërgjegjëse përmes rrjeteve sociale dhe forumeve online.

Në total, janë postuar **352** materiale

dhe aktivitete që janë parë në mënyrë interaktive nga **4676** përdorues, duke dëshmuar një interes të madh nga publiku.

Për më tepër, janë regjistruar gjithsej **151** komente në këto postime, të cilat në pjesën më të madhe kanë qenë pozitive, përshëndetëse dhe vlerësuese për punën dhe përkushtimin e treguar nga specialistët e Policisë së Shtetit.

